



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Lubjanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**PSH. Nr. 371/23**

Paneli Shqyrtues i Prokurimit, i emëruar nga OSHP sipas nenit 105 dhe 106 të Ligjit për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092) në përbërje nga Isa Hasani -Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani dhe Vedat Poterqoi- Anëta, bazuar në neni 98, paragrafi 1, nenin 105, paragrafi 2, lidhur me nenin 99 paragrafi 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (versioni i konsoliduar) dhe nenit 32 të Rregullores së Punës së OSHP duke vendosur lidhur me kërkesën për "paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik" e parashikuar me nenin 99, paragrafi 2, i LPP e parashtruar me 06.04.2023 nga Ministria e Punëve të Brendshme, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK), ndaj Operatorit Ekonomik (OE) "Al-Ber" SH.P.K Suhareke, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rikonstruimi dhe ndërtimi i aneksit të objektit të QRA-QPD në Ferizaj" me numër të prokurimit 214-22-8480-5-2-1, me 29.02.2023, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet si e bazuar kërkesa e datës 06.04.2023, Protokolli 371/2023, e Ministrisë së Punëve të Brendshme, e parashtruar në cilësinë e AK, për shkak të paraqitjes së të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga OE "Al-Ber" SH.P.K., sipas nenit 99 paragrafi 2 të LPP , diskualifikohet nga pjesëmarrja në aktivitetin e prokurimit "Rikonstruimi dhe ndërtimi i aneksit të objektit të QRA-QPD në Ferizaj" me numër të prokurimit: 214-22-8480-5-2-1 dhe i ndalohe pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit publik për periudhën kohore 1/ një vit, duke filluar nga data 28.02.2024 deri me datën 27.02.2025.
2. Urdhërohet AK, respektivisht Ministria e Punëve të Brendshme, që ta bëjë konfiskimin e sigurisë së tenderit për OE, me të dhëna si në paragrafin paraprak të dispozitivit të këtij vendimi.
3. Do të revokohet masa e shqiptuar si në paragrafin 1, të dispozitivit të këtij Vendimi, nga dita kur dhe nëse OSHP njoftohet me aktin e organeve kompetente, sipas të cilit vërtetohet se vepra e kualifikuar sipas paragrafit 1, të dispozitivit të këtij vendimi, nuk është kryer.

## A r s y e t i m

Me 06.04.2023, Ministria e Punëve të Brendshme në cilësinë e AK, ka dorëzuar në OSHP, kërkesë për aplikim të masave sipas nenit 99 pika 2 të LPP, ndaj OE "Al-Ber" SH.P.K, me seli në Suhareke, nën pohimin se ekziston dyshimi për paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar, sikurse parashihet me nenin 99 par 2 të LPP.

Duke ju referuar kërkesës së cituar si më sipër, konstatohet se si arsye për marrjen e masave në pajtim me nenin 99.2 të LPP, AK (me të dhëna si më sipër) ka deklaruar se OE "Al-Ber" në aktivitetin e prokurimit "Rikonstruimi dhe ndërtimi i aneksit të objektit të QRA-QPD ne Ferizaj" me numër të prokurimit 214-22-8480-5-2-1, ka prezantuar dokumente të falsifikuara, të cilat në rastin konkret e nënkuptojnë si të tillë:

1. Deklaratën e Garantuesit (Siguria e Tenderit) me numër 105483 që nuk është lëshuar nga KS "ELSIG" sha.

2. Deklaratën e Garantuesit ( Siguria e tenderit) me numër 106326 është lëshuar me datën 12.09.2022 në orën 14:11 nga KS "ELSIG" sha., me periudhën e mbulushmerise: 12.09.2022 – 16.12.2022, 95 dite.

Në këtë rast AK ka shpjeguar se: Njoftimin për kontratë në sistemin E-prokurimi me datë 18.08.2022 ndërsa kriteri për dhënie të kontratës ishte tenderi i përgjegjshëm me çmimin me të ulëte. Afati i fundit për dorëzim të tenderëve ishte me 12.09.2022. Po të njëjtën ditë përmes e-prokurimi është bere e ditur se janë dorëzuar 7 oferta. Prej tyre, 4 tender në baze të dokumentacionit janë vlerësuar të përgjegjshëm kurse 3 tender janë vlerësuar të pa përgjegjshëm. Zyrtari i prokurimit ka rekomanduar tenderin e operatorit ekonomik "AL-BER" SH.P.K. Suhareke bazuar në kriterin për dhënien e kontratës, meqë ka ofruar çmimin me të ulët 444.217.14 euro.

Por pas nënshkrimit të kontratës MPB në cilësinë e Autoritetit Kontraktues është njoftuar nga Policia e Kosovës- Drejtoria për Hetim të Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit se operatori ekonomik "AL-BER" SH.P.K. Suhareke, me rastin e aplikimit në tender ka dorëzuar dokumente të pa sakta ose mashtrues të cilat kanë vënë në lajthitje Autoritetin Kontraktues. AL-BER – SH.P.K. ka shkelur Deklaratën nën Betim duke paraqitur dokumente të pa sakta ose mashtruese, gjë e cila është e dënueshme në baze të nenit 67 të LPP-se.

Autoriteti Kontraktues MPB-Divizioni i Prokurimit i është drejtuar kompanisë së sigurimeve për të vërtetuar ligjshmërinë e dokumenteve të dorëzuar nga "AL-BER" SH.P.K.

Mbi bazën e kësaj vërtetohet se operatori ekonomik "AL-BER" SH.P.K. Suhareke ka shkelur Deklaratën nën Betim të nënshkruar dhe vulosur duke dhënë dëshmi të pa sakta në lidhje me Sigurimi i Tenderit gjithashtu edhe ka dhënë deklaratë mashtruese pranë AK, gjatë kohës së sqarimeve lidhur me sigurimet e dorëzuara. Andaj Autoriteti Kontraktues MPB me datë 31.03.2023 bazuar në rrethanat faktike të krijuara dhe neneve 49,85,89,97,98,100,109 dhe 114 të Ligjit Nr.04/L-007 për Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe nenit 54 paragrafi 1.1 dhe nenit 66 paragrafi 3 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka shkëputur kontratën me titull, " Rikonstruimi dhe ndërtimi i aneksit të objektit të QRA-QPD ne Ferizaj " me numër të prokurimit: 214-22-8480-5-2-1. e lidhur me Ministrin e Punëve të Brendshme dhe "AL-BER" SH.P.K Suhareke me numër identifikues 810124411. Si dhe ka konfiskuar sigurimin e Ekzekutimit me numër të polises Seria/ 110503 në

shumen prej 45.000 Euro e lëshuar nga Kompania e Sigurimeve ELSIG sh.a me date 03.02.2023 e vlefshme deri me 10/03/2024.

Me 07.04.2023, OSHP, pas pranimit të kërkesës së AK-së, e ka njoftuar OE "Al-Ber" SH.P.K, i cili përmes parashtrësës me shkrim është përgjigjur: Përmes këtij kundërshtimi paraqesim argumentet tona me te cilat do te argumentojmë se, Kërkesa e AK është e pabazuar dhe e kundërligjshme.

Se bashku me këtë kërkesë OSHP na është përcjell edhe Kërkesa e AK.

Pas marrjes se këtyre shkresave, leximit si dhe kuptimit te përmbajtjes se tyre, përmes këtij kundërshtimi, do te ju përcjellim sqarimet dhe kundërshtimet tona dhe ju njoftojmë se, para pak ditësh ne kemi marr nga AK edhe vendimin e AK nr.545-3 te datës 31.03.2023 për SHKËPUTJEN E KONTRATES me numër 214-22-8480-5-2-1/ C295, kundër te cilit kemi ushtruar Kundërshtim pranë te njëjtit organ si dhe Padi pranë Gjykatës Komerciale ne Prishtine.

Kërkesa e AK për diskualifikimin e OE "AL-BER" SH.P.K. ( futjen ne listën e zeze) ka ardhur pas marrjes se vendimit nga ana e tyre për Shkëputjen e Kontratës me numër 214-22-8480-5-2-1/ C295, kundër te cilit kemi ushtruar Kundërshtim pranë te njëjtit organ si dhe Padi pranë Gjykatës Komerciale ne Prishtine.

Kërkesa e AK për diskualifikimin e OE "AL-BER" SH.P.K. (futjen ne listën e zeze) ka ardhur pas marrjes se vendimit nga ana e tyre për Shkëputjen e Kontratës nr. AK 453-2 te datës 31.03.2023. Mbi bazën e këtij vendimi te paligjshëm, AK, përpos kërkesës ne OSHP ka bere kërkesë edhe ne KS "ELSIG" për konfiskimin e sigurimit te ekzekutimit te tenderit me police te sigurimit Seria/ 110503 ne shumen prej 45,000,00 euro e lëshuar nga Kompani e Sigurimeve ELSING me datën 03.02.2023. Duke menduar qe vendimi i AK është i pa bazuar dhe i kundërligjshëm, ne afat ligjor dhe ne përputhje me dispozitat ligjore, OE ka bere Kundërshtimin e këtij Vendimi pranë AK me datën 07.04.2023 si dhe Padi pranë Gjykatës Komerciale ne Prishtine me propozim për MASE TE PERKOHSHEM TE SIGURISE për te ndaluar çdo veprim te një anshëm te AK deri se kjo çështje te përfundoj me një Vendim nga ana e Gjykatëse.

Po ashtu OE deklaroi qe ne kërkesën e AK për diskualifikim pretendohet qe ne deklaratën e datës 18.10.2023 kemi bere mashtrime kjo nuk qëndron fare ne faktin se kjo është vërtetuar edhe nga ELSIG qe polica me nr.106326 është lëshuar me date 12.09.2022 me mbulushmeri 95dite ashtu siç ka qene e kërkuar, pra nuk behet fjale për mashtrim.

Dokumenti sigurimit te tenderit qe ju kemi dërguar AK është dokument i lëshuar nga KS "ELSIG" dhe nuk behet fjale për mashtrim apo diçka te tille, prandaj sikur deklarata e datës 18.10.2022 po ashtu edhe sigurimi i tenderit nuk janë mashtruese, deklaratën sa i përket sigurimit te tenderit e ka vërtetuar edhe eksperti i OSHP.

Andaj si përfundim vendimi si i tille nuk përmban as dispozita ligjore se ku është thirrur dhe ku i mbështet pretendimet e tij organi vendimmarrës. Vetëm këto e bëjnë te mjaftueshëm qe te anulohet vendimi nga vet organi qe ka nxjerr, por edhe kërkesa e saj te refuzohet si e pabazuar.

Paneli shqyrtues pas analizimit të akteve dhe veprimeve të palëve dhe pretendimeve reciproke të tyre, konstatoj se në lënda në rastin konkret përmban dokumente dhe shkresa të mjaftueshme, mbi bazën e të cilave Paneli ka të drejtë të vendos në aspektin meritor pa prezencën e palëve, sikurse parashihet kjo me nenit 24 paragrafi 1, të Rregullores së Punës së OSHP.

Gjatë administrimit të provave, vlerësimit të tyre, paneli shqyrtues konstatoi se nga kërkesa e AK dhe faktet e vërtetuara në mënyrë të pavarur nga OSHP dhe të shpjeguara si më sipër, konsiderohen prova të mjaftueshme të cilat kanë krijuar bindjen e këtij Paneli se OE "Al-Ber" SHPK, Suhareke, i njëjti ka paraqitur të dhëna të rreme që bien në kundërshtim me nenin 99 par 2 të LPP. Në fakt, nga gjetjet në dosjen e tenderit vërehet se veprimet e OE, në kuptimin se si janë përshkruar ato si më sipër, kanë të bëjnë me *paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik*, sikurse parashihet me nenin 99, paragrafi 2, të LPP dhe për këtë arsye, AK ka paraqitur në OSHP, me 06.04.2023, kërkesë për inicimin e procedurës së diskualifikimit në kuptim të dispozitës së cituar si më sipër.

Paneli Shqyrtues konsideron se në këtë rast se objektivisht lind detyrimi i OSHP, që ta zbatoj dispozitën e cituar si më sipër të LPP, sipas së cilës shprehimisht kërkohet që operatori ekonomik në rastin konkret të diskualifikohet nga pjesëmarrja në këtë aktivitet të prokurimit dhe (sipas gjykimit të pavarur të këtij Paneli) ti ndalohet e drejta për të marrë pjesë në aktivitet e prokurimit publik në periudhën kohore prej 1/ një viti, duke filluar nga data 03.08.2023 deri me 03.08.2024. Megjithatë, Paneli Shqyrtues sqaron se masa e diskualifikimit, e shqiptuar dhe shpjeguar si më sipër, mund te revokohet nga momenti kur dhe/ose nëse OSHP njoftohet nga autoritetet kompetente se vepra e cituar dhe e komunikuar sipas paragrafit 1, të dispozitivit të këtij vendimi, nuk është kryer.

Në lidhje me diskualifikimin e operatorit ekonomik bazuar në faktet e vërtetuara për falsifikim nga vetë Autoriteti Kontraktues, paneli sqaron se përgjegjësia për faktin e vërtetuar i takon AK-së. Edhe nëse eventualisht vërtetohet e kundërta e vendimit nga Gjykata kompetente, pasojat e kompensimit material mbeten në përgjegjësinë e AK-së.

Prandaj nisur nga të lartcekurat Paneli shqyrtues, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetare e Panelit Shqyrtues  
Isa Hasani



**Këshillë Juridike:**

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë që ti drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet;

- AK- Ministria e Punëve të Brendshme
- OE "Al-Ber" sh.p.k

- Arhivës së OSHP-së;
- Për publikim në ueb-faqe të OSHP-së